



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 09.07.2013
Nr.0203-910

PËR: Qemajl Mustafa, Kryetar i Komunës së Gjilanit
Izmi Zeka, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit

LËNDA: Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Rregullores të Komunës së Gjilanit, Nr.16/17876 pranuar më datën 08.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Rregullores për Kompensim të Pagës për ish Zyrtarët e Lartë të Komunës së Gjilanit **KONSTATON** se:

- Zyrtarët e lartë të Komunave siç janë Kryetarët e Komunave, Nënkryetarët e Komunave si dhe Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit e Kuvendit të Komunave, përjashtohen nga çdo lloj kompensimi për veç pagesës së rregullt, gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, siç e përcakton neni 10 i Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.16/2008 për Pagesën e Stafit Politik në Komuna.
- Përcaktimi i kompensimit pas përfundimit të mandatit të zyrtarëve të lartë, ose pas tërheqjes nga pozita të cilën e ushtron si staf politik në Komunë, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.16/2008 për Pagesën e Stafit Politik në Komuna.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Gjilanit që të ndër marrin veprime konkrete, që Rregulloren Nr.16/17876 për kompensim të pagës për ish zyrtarët e lartë të komunës të harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 09.07.2013
Br.0203-910

Za: Qemajl Mustafa, Gradonačelnik Opštine Gnjilane
Izmi Zeka, Predsedavajući Skupštine Opštine Gnjilane

PREDMET: Zahtev za razmatranje zakonitosti Uredbe Opštine Gnjilane,
Br.16/17876 prmllejno dana 08.07.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja zakonitosti Uredbe za nadoknadu plate za bivše visoke službenike Opštine Gnjilane **KONSTATUJE:**

- Visoki službenici Opština, kao što su Gradonačelnici Opština, Podpredsednici Opština, Predsedavajući i Zamenici predsedavajućih Skupština Opština, isključuju se iz svake vrste nadoknade u toku vršenja njihovih mandata kako određuje član 10 Administrativnog Uputstva Br.16/2008 o Isplati Političkog osoblja u Opštini .
- Svaka vrsta nadoknade posle završetka mandata visokih službenika, ili posle povlačenja sa položaja koju vrši kao političko osoblje u Opštini je u suprotnosti sa Zakonom br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu i Administrativnim Uputstvom Br.16/2008 o isplati Političkog Osoblja u Opštinama.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona za lokalnu samoupravu *traži* od Skupštine Opštine/Gradonačelnika Opštine Gnjilane da preduzmu konkretne mere da Uredbu Br.16/17876 za nadoknadu isplate za bivše visoke službenike Opštine da usklade sa zakonskim dispozicijama na snagu, u roku od 30 dana od datuma prijema zahteva za ponovno razmatranje akta .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republike of Kosovo

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministère e Lokalne Samoprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data: 08.07.2013			
Kodi:			
Udhëzuesi	Titulli	Shkronja	Shërb.
- 11 -	0008-910		

Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

RREGULLORE
PËR
KOMPENSIM TË PAGËS PËR ISH
ZYRTATARËT E LARTË TË KOMUNËS

Në pajtim me nenin 12.2 pika c) dhe d) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 15.07.2011, miraton:

R R E G U L L O R E N

PËR KOMPENSIM TË PAGËS PËR ISH ZYRTARËT E LARTË TË KOMUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore rregullohet kompensimi i pagës për ish zyrtarët e lartë të Komunës së Gjilanit, pas skadimit të mandatit, të cilët mbesin pa u sistemuar në vendet përkatëse të punës për shkak të rrethanave të parapara me këtë rregullore.

Neni 2

Zyrtar të lartë komunal në kuptim të kësaj rregulloreje konsiderohen: Kryetari i Komunës, Nënkyretar i Komunës, Kryesuesi, Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe drejtorët e drejtorive të Komunës.

II. DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 3

1. E drejta e kompensimit të pagës zyrtarëve të lartë komunal nga neni 2 i kësaj rregullore u takon në rastet në vijim:

- 1.1. nëse pas skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur ose emëruar nuk janë sistemuar në ndonjë vend pune;
- 1.2. nëse gjatë ushtrimit të mandatit të zyrtarëve të lartë komunal për shkak të paaftësisë së tij shëndetësore nuk është në gjendje që në mënyrë të përhershme ta ushtrroj funksionin e tij;
- 1.3. nëse gjatë ushtrimit të mandatit, zyrtari i lartë komunal vdes, e që familja tij nuk ka burime financiare.

Neni 4

1. E drejta e kompensimit të pagës për ish zyrtarët e lartë të komunës dhe ish anëtar të kuvendit të Komunës u takon që nga data e përfundimit të mandatit në funksionin në të cilin janë zgjedhur ose emëruar e deri në sistemin e tyre në ndonjë vend të punës, e jo më gjatë se katër vite.
2. E drejta e kompensimit për ish zyrtarët e lartë të komunës për shkak të paaftësisë së tyre objektive për ta ushtruar funksionin fillon nga dita e paraqitjes së paaftësisë së tyre, e vlen deri në fillimin e realizimit të hyrave financiare nga ndonjë burim tjetër, e jo më gjatë se një vit.

Neni 5

1. E drejta në Kompensimin e pagës prej 70% të pagës bazë i takon ish Kryetarit të Komunës, Nënkyretarit të Komunës, Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. E drejta në Kompensimin e pagës prej 70% të pagës bazë me kompensim i takon ish anëtarit të Kuvendit të Komunës.

